



KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA
KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS
TUŽILAČKI SAVET KOSOVA
KOSOVO PROSECUTORIAL COUNCIL

Nr.Ref.KGJK 01 / 191

Nr.Ref.KPK 144/2020

E lidhur me datën 09.03.2020;

**Marrëveshje
në mes të
Këshillit Gjyqësorë të Kosovës
dhe
Këshillit Prokurorial të Kosovës**

**për shkëmbimin e të dhënave në mënyre elektronike
nga SMIL-i**

**Neni 1
Palët**

- 1.1 Këshilli Gjyqësor i Kosovës adresa në: Rr. "Luan Haradinaj" p.n. Prishtinë, e përfaqësuar nga z. Skender Çoçaj, Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- 1.2 Këshilli Prokurorial i Kosovës adresa në: Rr. "Luan Haradinaj" p.n. Prishtinë, e përfaqësuar nga z. Bahri Hyseni, Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës;

Neni 2

Objekti i Marrëveshjes

Objekt i kësaj marrëveshje është ndërlidhja e sistemeve elektronike dhe shkëmbimi i të dhënave në formë elektronike në mes të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Neni 3

Qëllimi i Marrëveshjes

- 3.1 Qëllimi i kësaj Marrëveshje është rregullimi dhe përcaktimi i procedurave për shkëmbimin e të dhënave në formë elektronike nga sistemet për menaxhimin e informativ të lëndëve në prokurori dhe gjykatë.
- 3.2 Të gjitha të dhënat e përcaktuar sipas nenit 4 nga prokurori në gjykatë do të dërgohen në formë elektronike nga sistemet e tyre përkatëse për menaxhimin e lëndëve dhe anasjelltas.

Neni 4

Përgjegjësitë e palëve

- 4.1 Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës obligohen në formimin e një grupi të përbashkët për përcaktimin dhe mënyrën e shkëmbimit të të dhënave nga sistemet elektronike.
- 4.2 Grupi i përbashkët ka për obligim përgatitjen e Procedurës Standarde të Veprimit (tani e tutje PSV), e cila përmban të dhënat të cilat do të shkëmbehen.

Neni 5

Nënshkrimi i PSV

Me përfundimin e PSV për shkëmbimin e të dhënave, dhe me aprovimin e menaxhmentit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës, nënshkrimi i PSV do të bëhet nga udhëheqësit e Departamenteve të Teknologjisë Informative.

Neni 6

Kualiteti i të dhënave

Palët nënshkruese obligohen për saktësinë e të dhënave të cilat shkëmbehen në mënyrë elektronike mes të dy sistemeve.

Neni 7

Plotësimet dhe ndryshimet

Palët mund të bëjnë plotësime dhe ndryshime të nevojshme të kësaj marrëveshje në çdo kohë me pëlqimin e ndërsjellët të paraqitur me shkrim.

Neni 8

Mbajtja e takimeve

Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës përkatësisht departamentet gjegjëse të Teknologjisë Informative do të mbajnë takime të rregullta në rast të avancimit të sistemeve, me qëllim të njoftimit dhe mënyrës së shkëmbimit të të dhënave.

Neni 9

Shkëmbimi i informacioneve

- 9.1 Palët nënshkruese të kësaj Marrëveshje, garantojnë konfidencialitetin e çdo informacioni që administrohet dhe shkëmbehet nga sistemet, në pajtim me ligjin.

Neni 10

Mbikëqyrja e marrëveshjes

Vënia në zbatim e kësaj marrëveshje do të mbikëqyret në mënyrë të vazhdueshme nga udhëheqësit e Departamenteve të Teknologjisë Informative, duke përpiluar raport të veçanta të cilat përcjellën të menaxhmeti i Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Neni 11

Faza kalimtare

- 11.1 Krahas shkëmbimit të të dhënave në formë elektronike nga sistemet, në të njëjtën kohë do të bëhet shkëmbimi edhe në formë fizike.
- 11.2 Shkëmbimi i të dhënave paralel fizik/elektronik bëhet me qëllim që të sigurohet që të dhënat e dërguar janë të sakta dhe stafi është duke përdorur sistemin në mënyrë të kënaqshme.
- 11.3 Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës, pas një periudhe kohore do të bëjë vlerësimin për largimin e formës fizike të dërgimit të lëndëve.

Neni 12
Ekzemplarët e Marrëveshjes

- 12.1 Kjo marrëveshje përgatitet në 2 kopje ekzemplarë të së njëjtës përmbajtje, secila prej tyre nënshkruhet nga palët kontraktuese.

Neni 13
Hyrja në fuqi

- 13.1 Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit, ndërsa do të zbatohet në momentin që sistemet elektronike (ndërlidhja) të Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës janë funksional.

Palët nënshkruese

Këshilli Gjyqësor i Kosovës

z. Skender Çoçaj
Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës



Këshilli Prokurorial i Kosovës

z. Bahri Hyseni
Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës

